ALBANIAN
FINANCIAL
INTELLIGENCE
UNIT

Albanian Financial Intelligence Unit

Raporti Vjetor

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit Parave

Viti 2015

Numër 11

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

Raporti Vjetor
2015

Tiranë, 2015

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave

www.fint.gov.al
Ministria e Financave,
Bulevardi "Deshmoret e Kombit",
nr 3, Tiranë.
Tel: +355 4 22 44 602

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA....3
SHKURTIMET....4
MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM....5
HYRJE....6
DATAT KRYESORE....7
ZHVILLIMET KRYESORE DHE ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE....9
RAPORTIME NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE....9
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE....9
BURIMET BUXHETORE DHE PËRDORIMI I TYRE NGA DPPPP-JA....11
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE....11
Inspektimet në vend dhe në distancë....12
MASAT ADMINISTRATIVE....14
MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR....15
Raportimi i transaksioneve parasë fizike....15
RAPORTET E AKTIVITETIT TË DYSHIMTË....16
ANALIZIMI FINANCIAR DHE REFERIMI NË ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT....18
Bllokimet e përkohshme....20
MASAT E PËRKOHSHME / URDHRAT E BLLOKIMIT....20
TIPOLOGJI....21
SEKTORI I ANALIZËS STRATEGJIKE....25
ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE....26
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL....26
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR....27
Bashkëpunimi me FATF....27
Bashkëpunimi në kuadrin e grupit EGMONT....27
Bashkëpunimi me Komitetin MONEYVAL të KiE....28
Shkëmbimi i informacionit me NjIF....28
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2016....30

SHKURTIMET

AMF - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
BE - Bashkimi Europian.
DPD - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
DPPPP - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
DSIK - Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
EGMONT - Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë.
EKA - Ekspert Kontabël i Autorizuar.
ESW - Rrjeti Informatik i Sigurt i EGMONT.
FATF - Grupi i Veprimit Financiar.
FIU - Njësi e Inteligjencës Financiare.
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar.
ICRG - Grupi i Rishikimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar.
ILDKPI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
KBLKPP - Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.
KiE - Këshilli i Europës.
MONEYVAL - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave.
NjIF - Njësi e Inteligjencës Financiare.
NjPH - Njësia e Përbashkët e Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit.
PAMECA - Projekti Kundër Korrupsionit në Shqipëri.
PEP - Personat e Ekspozuar Politikisht.
PP - Prokuroria e Përgjithshme.
PPP/FT - Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
RAD - Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë.
RTPF - Raporti i Transaksioneve në Para Fizike.
RTV - Raporti i Transaksionit të Vlerave.
SHISH - Shërbimi Informativ Shtetëror.
TI - Teknologjia e Informacionit.
VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave.
ZKV - Zyrë Këmbimi Valutor.
ZQRPP - Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
PROTIK- Qendër Burimore në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit
AKSHI – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Njësia e inteligjencës financiare shqiptare ka vijuar të luajë një rol aktiv në sistemin parandalues, në investigimin dhe në referimin e rasteve të dyshimta. Ky rol i DPPPP-së nuk do të kishte qenë i mundur pa bashkëpunimin e subjekteve raportuese, të cilat, përgjithësisht, kanë treguar një bashkëpunim profesional gjithnjë në rritje. Më tej, gjatë vitit 2015 ka pasur edhe një konsolidim të mëtejshëm në marrëdhëniet me autoritetet mbikëqyrëse dhe ato të zbatimit të ligjit. Janë evidentuar problematikat e pazgjidhura dhe janë ndërmarrë hapa për adresimin e tyre.

Në saje të përkushtimit të institucioneve dhe ekipit, që kam pasur kënaqësinë të kryesoj, Shqipëria, gjatë vitit 2015, është hequr nga lista e vendeve në monitorim nga FATF dhe MONEYVAL, procese këto, që dëshmojnë punën e konsiderueshme dhe të gjithanshme nga institucionet shqiptare me mbështetjen në rritje të qeverisë.

Gjatë vitit është përmbyllur me sukses edhe dokumenti për vlerësimin kombëtar të riskut për PP/FT, dokument i cili në përmbushje të standardeve ndërkombëtare, nevojave dhe detyrimeve kombëtare, evidenton problematikat në drejtim të mbikëqyrjes dhe hetimit, veprat kryesore origjinës së pasurisë kriminale, faktorët që ulin dhe rrisin riskun si dhe kërcënimet.

Vëmendje e shtuar i është kushtuar trajnimit dhe sensibilizimit të subjekteve për çështjet e financimit të terrorizmit si dhe bashkëpunimit me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës në këtë drejtim.

Në përputhje me rrethanat dhe kërcënimet për terrorizëm dhe/ose radikalizëm, që kanë prekur mbarë botën, përfshirë dhe Ballkanin, janë ndërmarrë hapa konkretë në funksion të bashkëpunimit intensiv me strukturat kombëtare/ndërkombëtare të hetimit dhe investigimeve, duke pasur në vëmendje edhe trajnimin dhe ndërgjegjësimin e posaçëm të subjekteve raportuese për tipologji, problematika dhe mënyra zgjidhje të tyre.

Publikimi i raportit vjetor është edhe një rast tjetër për të falënderuar stafin e DPPPP-së për punën e vazhdueshme, të pakursyer dhe modestisht për t'u marrë shembull në vend.

Drejtori i Përgjithshëm

Genti GAZHELI

HYRJE

Publikimi i raportit vjetor, përveçse një detyrim ligjor i DPPPP-së, është edhe një mundësi për të shpalosur në mënyrë krejt të përmbledhur punën e kryer, statistikat përkatëse, bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me fokus të veçantë në marrëdhënien me subjektet.

Në raport gjendet informacion për:

- Llojin e raporteve të marra, të ndara për kategorinë e subjekteve raportuese;
- Përpunimin, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të marra;
- Shpërndarjen e rasteve të dyshimta për agjencitë e zbatimit të ligjit;
- Bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Përputhshmërinë e subjekteve ndaj kërkesave ligjore, inspektimet e kryera, masat e marra dhe trajnimet e realizuara;
- Tipologjitë e PP/FT;

Të dhëna, të cilat krijojnë një panoramë për mënyrën e organizimit/funksionit të DPPPP-së por edhe për arritjet e problematikat e hasura në sistemin parandalues.

Më anë të këtij raporti synojmë, së pari, informimin publik dhe veçanërisht subjektet raportuese për punën e DPPPP-së, por edhe adresimin e problematikave për aktorët përkatës në sistemin parandalues dhe atë goditës ndaj PP/FT.

DATAT KRYESORE

- Në maj të vitit 2000, Parlamenti Shqiptar, pas kërkesave të Këshillit të Europës dhe të Komitetit MONEYVAL, miratoi Ligjin nr. 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave";
- Në gusht të vitit 2001, u krijua për herë të parë Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave;
- Në qershor të vitit 2003, Parlamenti Shqiptar, në zbatim të kërkesave të raportit të vlerësimit të dytë të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL, bëri disa ndryshime të rëndësishme të ligjit "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave", nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 9084 datë 19.06.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave";
- Në korrik të vitit 2003, Njësia e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë u bë anëtare me të drejta të plota në grupin EGMONT, gjatë sesionit plenar të mbajtur në Australi;
- Në korrik të vitit 2004, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin nr. 9258 "Për masat kundër financimit të terrorizmit";
- Në gusht të vitit 2005, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave u ngrit në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave;
- Në mars të vitit 2006, u publikua raporti i parë vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Në gusht të vitit 2006, KBLKPP miratoi Programin Kombëtar të Kontrollit të Lëvizjes së Parasë në dorë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Në nëntor të vitit 2006, u miratua Ligji nr. 9641, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Parandalimin e Terrorizmit" dhe ligji nr. 9646, datë 27.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe të Financimit të Terrorizmit";
- Në janar të vitit 2008, me Urdhër të Kryeministrit të Shqipërisë, u miratua struktura e re e DPPPP-së, në të cilën u krijua për herë të parë Sektori i Teknologjisë së Informacionit;
- Në maj të vitit 2008, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i cili hyri në fuqi në shtator të po atij viti;
- Në shtator të vitit 2009, përfundoi projekti i binjakëzimit "Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar", në bashkëpunim me Zyrën Kriminale Federale Gjermane;
- Në tetor të vitit 2009, me Vendimin nr. 1077, datë 27.10.2009, të Këshillit të Ministrave, u miratua Dokumenti Strategjik Kombëtar "Për hetimin e krimit financiar", në hartimin e të cilit DPPPP-ja kishte rol drejtues;
- Në nëntor të vitit 2009, DPPPP-ja prezantoi para Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare punën dy vjeçare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

- Në nëntor të vitit 2010, u zhvillua në vend vizita e Misionit të Katërt Vlerësues të FMN-së, për masat e marra nga Shqipëria në fushën e parandalimit e goditjes së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Në mars 2011, filloi projekti i dytë i binjakëzimit të financuar nga BE-ja "Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri";
- Në mars 2011, Parlamenti Shqiptar bëri disa ndryshime në ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit", nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 10391 datë 03.03.2011;
- Në prill 2011, Komiteti MONEYVAL i KiE miratoi raportin e raundit të katërt për Shqipërinë, ku pasqyrohet vlerësimi në rritje për Rekomandimin e 26 të FATF dhe që lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë e DPPPP-së si Njësi e Inteligjencës Financiare;
- Në shkurt 2012 përfundoi vlerësimi i riskut mbi ekspozimin e sektorit jo fitimprurës në Shqipëri ndaj financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimin special të VIII të FATF;
- Në qershor 2012, u amendua Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit";
- Në tetor 2012 përfundoi dhe iu paraqit Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave dokumenti për "Vlerësimin kombëtar të riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
- Në muajin prill 2013, përfundoi projekti i BE-së "Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri";
- Në muajin korrik, pjesëmarrja e drejtuesve të DPPPP-së në mbledhjen plenare të Grupit Egmont të NjIF;
- Në muajin tetor 2013, DPPPP-ja organizoi konferencën rajonale të drejtuesve të NjIF;
- Në muajin tetor 2013, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin "Për masat kundër financimit të terrorizmit";
- Në shkurt 2014, u miratua nga Kryeministri i vendit struktura e re e DPPPP-së;
- Në tetor 2014, u organizua takimi i KBLKPP nën kryesimin e Kryeministrit të vendit;
- Në maj 2015, Shqipëria përmbylli procesin e realizimit të rekomandimeve të FATF dhe u hoq nga lista publike e vendeve me mangësi në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Në qershor 2015 përfundoi rishikimi i vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT, dokument i cili është shpërndarë për institucionet dhe autoritetet përkatëse;
- Në shtator 2015, komiteti Moneyval i KiE mori në shqyrtim progresin e bërë nga vendi ynë në drejtim të rekomandimeve të raundit të IV të vlerësimit dhe bazuar në masat e ndërmarra nga autoritetet vendosi ndërprerjen e procedurës së mbikëqyrjes së përforcuar;

ZHVILLIMET KRYESORE DHE ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE

MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në zbatim të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 *"Për masat kundër financimit të terrorizmit"* i ka kushtuar rëndësi të veçantë dhe ka ndjekur në vijimësi ndryshimet që pësoi lista sipas vendimeve të Komitetit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me ndryshimet në VKM nr. 718, datë 29.10.2004, *"Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit",* ndryshime të miratuara me 15 vendime të Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe nenit 15 të ligjit nr. 157/2013 "*Për masat kundër financimit të terrorizmit*" është realizuar shpallja e personave si terroristë me procedurë të brendshme me propozim të DPPPP-së, me Vendim nr. 589 datë 01.07.2015 i Këshillit të Ministrave.

RAPORTIME NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në grupet e punës, në kuadër të proceseve për integrimin e vendit në BE, duke dhënë kontributin për sa lidhet me aktivitetet e saj. Në këtë kuadër, DPPPP-ja është anëtare e grupit ndërinstitucional të punës për kapitullin 24 *"Drejtësia, Liria dhe Siguria",* është pjesë e grupit të punës për adresimin e 5 prioriteteve të BE, prioriteti 4 *"Lufta kundër krimit të organizuar".* Vlen të theksohet se të gjitha masat e parashikuara në planet e punës dhe objektivat e vendosura në kuadër të këtyre angazhimeve janë përmbushur nga DPPPP-ja brenda afateve të parashikuara.

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve gjatë vitit 2015, ka pasur në qendër të vëmendjes menaxhimin me efikasitet të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, të vëna në dispozicion të DPPPP-së.

Në këtë kontekst, një vëmendje e veçantë i është kushtuar nga ky sektor mbarëvajtjes së funksionimit të DPPPP-së, në mënyrë që të sigurohet performanca optimale e institucionit. Për këtë qëllim, janë trajtuar me vëmendje të veçantë problemet e evidentuara, për të cilat janë dhënë dhe zgjidhjet e përshtatshme.

Gjatë vitit 2015 është implementuar struktura e re e DPPPP-së me organizim të ri në tre drejtori. Për t'i dhënë rëndësinë e veçantë marrëdhënieve me institucionet homologe dhe institucionet e treta në shkëmbimin e informacionit është krijuar Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Jashtë.



Është paraqitur plani i nevojave për rekrutim dhe në këtë kuadër procedurat e konkurseve dhe pranimit të nëpunësve në shërbimin civil në vijimësi janë ndjekur në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike.

Gjatë vitit është realizuar në vijimësi procedura e pajisjes me certifikatë sigurie e punonjësve të DPPPP-së, në bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Këshillit të Ministrave.

Është ndjekur me rigorozitet procesi i vlerësimit të punës dhe performancës së çdo punonjësi në vijimësi, duke i kushtuar rëndësi të posaçme shmangies së konfliktit të interesave dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore për deklarimin e pasurive, procese që janë monitoruar dhe vlerësuar pozitivisht edhe këtë vit nga ILDKPI.

Në funksion të forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore, punonjësit e DPPPP-së kanë marrë pjesë aktive në aktivitetet e trajnimit të organizuara gjatë vitit 2015 nga Grupi Egmont, Komitetit MONEYVAL i KiE dhe projekti PAMECA IV.

Në vijim paraqiten disa nga tematikat e trajnimeve të sipërpërmendura:

- Praktikat më të mira në hetimin dhe procedimin e veprave penale të krimit financiar;
- Ekspert vlerësues i MONEYVAL për Rekomandimet e FATF;
- Konfiskimi i produkteve të krimit kibernetik;
- Teknikat e hetimit financiar dhe analiza strategjike;

Gjatë këtij viti, rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe trajnimeve të organizuara nga institucione vendase, si: “Shkolla Shqiptare e Administratës Publike”, “AKSHI” dhe qendra “PROTIK”, në lidhje me hartimin e termave të referencës për projektet e teknologjisë së informacionit në administratën publike.

BURIMET BUXHETORE DHE PËRDORIMI I TYRE NGA DPPPP-JA

Njëkohësisht gjatë vitit 2015, bazuar në legjislacionin dhe aktet normative në fushën e menaxhimit financiar është ndjekur në vijimësi përdorimi i fondeve buxhetore të akorduara nga Ministria e Financave, për të cilat janë përgatitur pasqyra të detajuara financiare dhe është bërë raportimi në mënyrë periodike për realizimin e prokurimeve publike.

Në vijim, paraqiten në mënyrë grafike fondet e akorduara dhe përdorimi i tyre nga DPPPP-ja për periudhën 2013 - 2015.

Grafiku nr. 1



NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE

Në përmbushje të detyrave që ngarkon ligji, DPPPP-ja është treguar aktive në drejtim të ndërgjegjësimit dhe trajnimit të subjekteve të ligjit, duke organizuar takime qoftë me subjektet e ligjit ashtu dhe me autoritetet mbikëqyrëse, e kryesisht me Shoqatën Shqiptare të Bankave. Fokusimi i DPPPP-së ka qenë sensibilizimi dhe ndarja e praktikave më të mira të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me subjektet financiare dhe noterët.

Gjatë vitit 2015, rëndësi të veçantë në të gjitha trajnimet me kategori të ndryshme të subjekteve kanë pasur masat kundër financimit të terrorizmit si një element shqetësues rajonal dhe ndërkombëtar, kjo nisur dhe nga aktet terroriste në botë që kanë shoqëruar vitin 2015.

Në këtë drejtim shërben edhe faqja zyrtare e DPPPP-së, në të cilën subjektet e ligjit njihen me tipologjitë, treguesit dhe vendet me mangësi në zbatimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Më poshtë paraqiten të dhëna për kategorinë dhe numrin e subjekteve të trajnuara në periudhën 2013 - 2015;

Tabela nr. 1

SUBJEKTI	NR. I PERSONAVE TË TRAJNUAR		
	VITI 2013	VITI 2014	VITI 2015
Banka të Nivelit të dytë	84	120	285
Zyra këmbimi valutor	151	70	73
Institucione jo bankë	0	68	115
Lojëra fati	15	12	0
Noterë	75	237	73
Ekspert kontabël	63	1	0
Shoqëri sigurimi të jetës	0	0	35
Autoritete mbikëqyrëse dhe institucione (AMF, ZQRPP, DPPSH, DPD, DPT)	13	139	58
Shoqëri tregtimi të automjeteve	0	14	0
Organizata jofitimprurëse	0	0	45
Shoqëri ndërtimi	0	38	0
Institute të pensioneve private	0	0	5
TOTALI	**401**	**699**	**689**

Trajnimet janë organizuar duke përfshirë të gjithë kategoritë e subjekteve dhe vëmendje e veçantë i është kushtuar kategorisë së subjekteve që paraqesin risk më të lartë për PP/FT.

Gjithashtu, në lidhje me OJF-të, për shkak të riskut që ato paraqesin për FT, është organizuar trajnim sensibilizues në këtë drejtim dhe më tej është bashkëpunuar edhe me DPT-në si organ mbikëqyrës i tyre.

Inspektimet në vend dhe në distancë

Vlerësimi i përputhshmërisë së subjekteve raportuese me detyrimet ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit mbetet një ndër funksionet kryesore që kryen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Mbikëqyrja e subjekteve raportuese gjatë vitit 2015 ka përfshirë inspektimet në vend dhe në distancë, shqyrtimin e raportimeve dhe informacioneve të administruara nga subjektet raportuese, por edhe autoritetet mbikëqyrëse.

Bazuar në analizën e riskut të përputhshmërisë, mbikëqyrja e ushtruar nga DPPPP-ja është orientuar ndaj atyre sektorëve, të cilët janë më të ekspozuar ndaj pastrimit të produkteve të veprave penale dhe financimit të terrorizmit.

Gjithashtu, viti 2015 ka qenë i rëndësishëm edhe në drejtim të koordinimit të aktivitetit mbikëqyrës me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese si edhe realizimit të inspektimeve të përbashkëta, kryesisht në subjektet financiare.

Inspektimet për periudhën 2013 - 2015.

Tabela nr. 2

Nr.	Subjektet e inspektuara	Viti 2013		Viti 2014		Viti 2015	
		Në vend	Në distancë	Në vend	Në distancë	Në vend	Në distancë
1	Banka	7	-	7	-	6	7
2	Institucione fin. jo-bankë	-	-	3	1	7	2
3	ZKV	2	110	19	8	22	6
4	Shoqëri ndërtimi	-	10	18		15	7
5	Noterë	1	19	4	67	13	1
6	Lojëra fati	-	-	3	-	-	8
7	Metale të çmuara	-	-	3	-	-	-
8	EKA	-	27	3	16	5	1
9	Imobiliare	-	8	2	-	-	-
10	Mjete motorike	-	-	8	1	-	-
11	Sigurimi i jetës	-	-	1	-	2	-
12	IPP	-	-	0	-	-	-
13	Agjenci udhëtimi	-	-	1	-	-	-
14	Studio ligjore	-	-	-	-	3	-
15	Shoqëri transporti	-	-	-	-	1	-
16	Vepra arti	-	-	-	-	1	-
17	Shoqëri administrimi letra me vlerë	-	-	-	-	-	4
18	SHKK						4
	Shuma	**10**	**174**	**72**	**93**	**75**	**40**
	TOTALI		**184**		**165**		**115**

Siç vërehet dhe nga tabela, subjektet financiare përbëjnë pothuajse gjysmën e atyre të inspektuara në vend, gjë që përbën një tregues të qartë të orientimit të burimeve njerëzore në këtë kategori subjektesh.

Grafiku nr. 2



Në vijim paraqiten disa nga mangësitë kryesore të përputhshmërisë:

- Mosraportimi i transaksioneve të kryera në para fizike mbi pragun e përcaktuar në ligj;
- Mosidentifikimi i klientëve dhe mos ruajtja e këtyre dokumenteve në përputhje me parashikimet ligjore
- Mos kryerja e analizave për transaksionet komplekse, në vlera të larta, të pazakonta dhe të pa justifikuara nga pikëpamja ekonomike;
- Mosushtrimi i masave të "Vigjilencës së zgjeruar" për kategoritë e klientëve të konsideruar me risk të lartë;
- Mosngritja një sistemi të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, duke përfshirë në të dhënat minimale të parashikuara.

MASAT ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2015 janë shqyrtuar aktet dhe praktikat, për të cilat janë konstatuar kundërvajtje administrative, nëpërmjet inspektimeve (në vend dhe në distancë) dhe është ndjekur në vijimësi procesi i masave administrative të vendosura.

Në këtë këndvështrim, sipas një procedure administrative të mirë përcaktuar, janë marrë dhe masat administrative, si masë shtrënguese për detyrimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, nga ku janë vendosur 34 masa administrative.

Kundërvajtjet administrative për subjektet e ligjit për PPP/FT konsistojnë në;

- Shkelje të nenit 4, 4/1 dhe 5 të ligjit për identifikimin dhe mbajtjen e dokumentacionit të kërkuar për identifikim si dhe mosmbledhje të të dhënave për burimin e të ardhurave;
- Shkelje të nenit 11 për masat parandaluese;
- Shkelje të nenit 8 në lidhje me vigjilencën ndaj PEP;
- Shkelje e nenit 12, pika 3 të ligjit për raportimin e transaksioneve sipas këtij neni.

Nëpërmjet tabelës jepen numri dhe vlerat e gjobave sipas llojit të subjekteve të proceduara:

Tabela nr. 3

SUBJEKTE	VITI 2013		VITI 2014		VITI 2015	
	Nr. i masave	Vlera e gjobave në LEK	Nr. i masave	Vlera e gjobave në LEK	Nr. i masave	Vlera e gjobave në LEK
Banka të Nivelit të Dytë	2	8'500'000	5	4'430'000	2	6'000'000
Zyra këmbimi valutor	6	5'700'000	7	4'300'000	8	6'800'000
Noterë	5	1 '700'000	29	9'700'000	4	2'700'000
Institucione jo bankë	0	0	2	800'000	3	2'200'000
Lojëra fati	0	0	3	2'500'000	0	
Shoqëri ndërtimi	0	0	11	6'800'000	15	14'700'000
Agjenci udhëtimi	0	0	0	0	1	300'000
Shoqëri sigurim jete	0	0	0	0	1	2'000'000
TOTALI	**13**	**15'900'000**	**57**	**28'530'000**	**34**	**34'700'000**

Në tabelën në vijim paraqiten masat administrative dhe arkëtimet për periudhën 2013-2015.

Tabela nr. 4

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Vendime per gjoba	13	57	34
Subjekte që kanë arkëtuar vullnetarisht	7	35	16
Shuma totale e vlerës së gjobave	15 900 000	28 530 000	34 700 000
Shuma totale e arkëtuar	16 661 000	34 235 705	17 656 000

Gjatë vitit 2015 janë arkëtuar në total 17 656 000 lekë, nga të cilat 12 656 000 lekë janë arkëtime nga masat administrative të vendosura në vitin 2014 dhe 5 000 000 lekë arkëtime të masave administrative të viteve të mbartura nga masat administrative të vendosura në vitet e mëparshme.

Nga masat administrative të vendosura gjatë këtij viti, 16 subjekte janë pranuar dhe likuiduar vullnetarisht nga subjektet, kurse për pjesën tjetër ka vazhduar ankimimi në rrugë gjyqësore. DPPPP-ja ka studiuar me vëmendje praktikat gjyqësore në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të procedimit administrativ, si dhe të unifikimit të praktikave për zbatimin e legjislacionit për parandalimin e PP/FT nga subjektet.

DPPPP-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndjekjes së proceseve gjyqësore në lidhje me masat administrative të vendosura nga institucioni, nga ku janë gjithsej 30 çështje gjyqësore të përfunduara gjatë këtij viti, nga të cilat 25 vendime janë dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe 5 vendime janë dhënë nga Gjykata e Administrative e Apelit.

MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR

Raportimi i transaksioneve të parasë fizike

Raportimi i transaksioneve në para fizike vijon të jetë një ndër burimet e informacionit që raportohen nga subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në lidhje me ecurinë e këtij raportimi për periudhën 2013-2015.

Grafiku nr. 3. Raportimi i transaksioneve në para fizike



RAPORTET E AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Raportet e Aktivitetit të Dyshimtë vijojnë ecurinë pozitive me rritje cilësore dhe gamë subjektesh raportuese, duke qenë kështu treguesi kryesor dhe më i rëndësishëm që shpreh funksionim e sistemit parandalues dhe më tej reflekton drejtpërdrejt dhe në referimin e rasteve të dyshimta nga DPPPP-ja për agjencitë e zbatimit të ligjit. Kështu RAD për periudhën 2013-2015 janë si vijon:

Tabela nr. 5

SUBJEKTI	2013	2014	2015
Banka	420	822	585
Shoqëri transfertash	45	74	79
DPD	36	48	45
DPT	10	50	7
ZQRPP	20	64	210
Noter	15	122	303
ZKV	8	16	17
ILDKPKI	0	6	0
Shoqëri auditimi	1	0	
Ekspert kontabël	1	4	1
Institucione financiare të mikrokredisë		2	
Avokat	1	2	
Shoqëri të qiradhënies financiare	0	4	
Shoqëri ndërtimit		4	1
Shoqëri tregtimi mjetesh motorike		9	36
Shoqëri leasing			7
Agjenci udhëtimi			1
Shoqëri kursim krediti			1
Shoqëri spedicionere			2
Shoqëri pagesash elektronike			19
Tjetër	1	3	5
Total	558	1230	1319

Nga të dhënat e tabelës vërehet një rritje prej afro 7% e numrit të RAD, krahasuar me vitin 2014 dhe prej afro 136 % krahasuar me vitin 2013. Në lidhje me analizimin në detaj të këtyre të dhënave, vlen të evidentojmë se:

- Rënia e numri të RAD të dërguara nga subjektet banka, gjatë vitit 2015, shpjegohet kryesisht me mosraportimin e një tipologjie konkrete (transferta me natyrë biznesi nga llogari individuale), problematikë e cila në saje të bashkëpunimit me strukturat tatimore në vend është arritur të reduktohet. Duke përjashtuar këtë tipologji, që gjatë vitit 2014 ka zënë afro 33% të numrit total të RAD (407/1230), rezulton se ka rritje të numri të RAD nga sistemi bankar.

RAD e sistemit bankar përgjithësisht janë karakterizuar nga dinamizmi dhe shumëllojshmëria e tyre, si dhe dërgimi në kohë që provohet edhe me urdhrat e bllokimit që DPPPP-ja ka nxjerrë mbi bazë të këtyre RAD.

- RAD që lidhen me drejtpërdrejt me tjetërsimin e pasurive të paluajtshme (noter dhe ZQRPP) kanë shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me çdo vit tjetër dhe zënë 41% të totalit të RAD për vitin 2015. Rezultojnë ende problematika në drejtim të përshkrimit dhe arsyetimit të këtyre RAD-ëve, por këto janë adresuar rast pas rasti me vetë subjektet, autoritetin mbikëqyrës (Ministrinë e Drejtësisë) dhe në kuadër të sensibilizimit nëpërmjet trajnimeve.
- Raportimet e DPD-së kanë të njëjtin trend dhe tipologji, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa raportimet e DPT-së kanë një rënie të thellë dhe të pashpjegueshme, problematikë e adresuar në mënyrë institucionale (nëpërmjet takimeve dhe shkresave). Për DPT-në dhe DPD-në është evidentuar nevoja e dërgimit të RAD në përputhje me trendin dhe konkluzionet e vlerësimit të riskut, sipas të cilit fondet që gjenerohen nga veprat mëmë/origjinës në fushën tatimore/doganore (pra tregtisë) konkurrojnë me ato të krimit të organizuar.
- Raportimet e shoqërive të transfertave dhe ZKV-ve kanë ruajtur të njëjtin trend dhe për këto kategori subjektesh janë organizuar trajnime të shumta në kuadër të njohjes me tipologji të reja, rritjes së ndërgjegjësimit dhe evidentimit të pasojave të mosraportimit të RAD.
- Raportimet e shoqërive të tregtimit të mjeteve motorike kanë shënuar rritje, element ky që tregon se persona të dyshimtë vijojnë të investojnë fondet e tyre në automjete.

Tipologjitë kryesore të RAD për vitin 2015 janë si vijon:

- Transferta të dyshimta me/nga jashtë;
- Derdhje me para në dorë në shuma të konsiderueshme;
- Përdorimi i llogarisë individuale për qëllime biznesi/evazion fiskal;
- Veprime jashtë profilit të klientit;
- Dyshime lidhur me aktivitete të import/eksportit të mallrave;
- Deklarim/Mosdeklarim të vlerave në kufi;
- Mashtrim;
- Përfshirje të PEP-së në transaksione;
- Dyshime për financim terrorizmi;
- Sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga/për të tretë;
- Blerje pasurish të paluajtshme/luajtshme me burim të panjohur të fondeve;
- Mosidentifikimi i pronarit përfitues;
- Veprime/transaksione të mbetura të tentativë;
- Transaksione të kryera nga OJF;
- Kryerja e një aktiviteti ekonomik fiktiv;
- Transaksione të kryera nga /drejt kompanive të lojërave të fatit;
- Veprime financiare nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale;
- Përdorimi i instrumenteve bankare me anomali/falsifikuar (letër kredi/çek etj);
- Përdorim i dyshimtë i kredive bankare;
- Këmbime valutore në vlera të larta.

Në lidhje me RAD-et e marra nga subjektet, DPPPP-ja në përputhje me tipologjitë, natyrën dhe përshkrimin e tyre, konkluzionet e vlerësimit të riskut, eksperiencën e trajtimit të rasteve nga agjencitë e zbatimit të ligjit, ka vijuar të përcaktojë prioritetet për trajtimin e tyre.

ANALIZIMI FINANCIAR DHE REFERIMI NË ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT

Bazuar në analizimin e informacionit të marrë në përputhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, DPPPP-ja për vitet 2013 -2015 ka informuar organet kompetente sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku nr. 4



Gjatë vitit 2015 numri i referimeve për Policinë e Shtetit dhe/apo Prokurorinë ka një rënie, dhe kjo diktohet nga sinjalizimet/RAD e marra, fakti se për një pjesë e rasteve që janë analizuar është dërguar informacion vijues për personat e përfshirë në praktika të referuara më pare (pra nuk janë numëruar si referime të reja) dhe më tej më shumë se një RAD, herë pas here për shkak të tipologjisë specifike apo personave të përfshirë janë dërguar me një referim të vetëm në prokurori dhe/ose polici.

Një pjesë e konsiderueshme e rasteve të referuara janë shoqëruar dhe me urdhra bllokimi të përkohshëm fondesh, nga të cilët afro 70% janë sekuestruar me vendim gjykate/prokurorie.

Indicia për referimet e DPPPP-së në agjencitë e zbatimit të ligjit gjatë vitit 2015 është si më poshtë:

Tabela nr. 6

Indicia	RAD	RTPF	Analiza sektoriale	NJIF partnere	Njoftime	Total
Referimet në prokurori	80	6	11	5	18	120
Referimet në polici	212	4	41	7	17	281
Totali	292	10	52	12	35	401

Siç vërehet në tabelë, afro 73% e rasteve të referuara në organet e zbatimit të ligjit kanë si burim RAD e subjekteve raportuese, më tej analiza sektoriale për shoqëritë e transfertave ka qenë gjithashtu një burim i rëndësishëm me afro 13% të totalit të referimeve, të ndjekur me afro 9% nga njoftimet (nga institucione kryesisht publike), 3 % nga bashkëpunimi me homologët dhe 2% nga RTPF.

Në lidhje me RAD që kanë shërbyer si indicie për referimet, nëse e kategorizojmë sipas llojit të subjektit raportues, për vitin 2015 paraqitet si vijon:

Tabela nr.7

Referuar	RAD banka	RAD shoq transfertash	RAD Noter	RAD Inst shtetëror	Tjetër	Total
Prokurori/Polici	171	30	41	40	10	290

Ashtu si edhe në vitet e kaluara, dominojnë indiciet e RAD nga bankat (59% të totalit), të ndjekur nga RAD e noterëve, institucioneve shtetërore dhe shoqërive të transfertave.

Megjithëse DPPPP-ja, është NjIF e tipit administrativ (pa kompetenca hetimi), mbi bazë të të dhënave konfidenciale apo nga burime të hapura, ka arritur të përcaktojë lidhjen e mundshme me veprën e origjinës për një pjesë të rasteve të referuara, të cilat paraqiten të kategorizuara si më poshtë për periudhën 2013-2015.

Tabela nr.8

Vepra e origjinës	2013	2014	2015
Nuk përcaktohet	196	300	224
Trafikim të lëndëve narkotike	18	50	48
Mashtrim/Falsifikim	17	20	20
Fshehje të ardhurash/Evazion fiskal	28	40	38
Korrupsion	7	7	11
Grabitje/vjedhje	2	10	5
Trafikim i mjeteve motorike	2	2	0
Trafikim qeniesh njerëzore/shfrytëzim prostitucioni	4	9	6
Precedent penal të tjerë	3	15	16
Vrasje		2	3
Mos deklarim ne kufi		4	14
Kontrabandë dhe prodhim/shitje e lëndëve të rrezikshme	1		2
Procedim penal për pastrim parash	2		4
Dyshime për financim terrorizmi	1	3	2
Krijim organizate kriminale	1		6
Kambizëm i palicencuar	1		
Ushtrim i palicencuar i aktivitetit të lojërave të fatit			3
Totali	**283**	**462**	**402**

Siç shihet nga sa më sipër, dominojnë rastet për të cilat vepra penale mëmë nuk ka qenë e mundur të përcaktohet, por për këto raste analiza financiare ka arritur në përfundimin se:

- Fondet e qarkulluara nuk kanë pasur burime të ligjshme;
- Veprimet financiare kanë pasur anomali të dukshme;
- Qëllimi ekonomiko-ligjor ka qenë i dyshimtë,
- Kanë pasur ngjashmëri të theksuara me tipologjitë e njohura ndërkombëtare.

Nga rastet për të cilat ka qenë e mundur të individualizohet vepra mëmë, dominojnë trafikimi i lëndëve narkotike, fshehja e të ardhurave/evazion fiskal, mashtrimi, falsifikimi, trafikimi i qenieve njerëzore, korrupsioni, mosdeklarimi në kufi etj.

Kategorizimit sipas veprave të origjinës do të vijohet t'i kushtohet rëndësi e veçantë në të ardhmen, për vetë rolin që ky proces ka në analizën strategjike të informacionit, identifikimin e tendencave dhe tipologjive si dhe vlerësimit të riskut të PP/FT në shkallë vendi.

Për rastet e lidhura me evazionin fiskal/fshehjen e të ardhurave DPPPP-ja ka informuar edhe DPT-ja për të ndërmarrë veprime të mëtejshme, në kuadër të Njësive të Përbashkëta Hetimore apo më gjerë.

BLLOKIMET E PËRKOHSHME

DPPPP-ja, në kuadrin e përmbushjes së funksionit parandalues, nxjerr dhe urdhra bllokimi në rastet kur ka të dhëna apo informacione të mjaftueshme së po kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit dhe të dhënat e viteve të fundit paraqiten në vijim:

MASAT E PËRKOHSHME / URDHRAT E BLLOKIMIT

Për vitin 2015, janë nxjerrë 47 urdhra bllokimi, të cilat kapin shifrën prej afro 16 milion euro, nga të cilat afro 11 milion euro janë sekuestruar me vendim gjykate.

Grafiku nr. 5



Në lidhje me rastet për të cilat janë nxjerrë urdhra bllokimi i është kushtuar vëmendje e posaçme bashkëpunimit me Prokurorinë dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit, veprimtari kjo që ka lehtësuar procesin e sekuestrimit të fondeve nga Gjykata/Prokuroria.

TIPOLOGJI

Në kuadrin e rritjes së mëtejshme të kapaciteteve parandaluese të subjekteve të ligjit, në vijim, paraqiten disa tipologji të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit, të cilat kanë qenë subjekt i punës së DPPPP-së.

TIPOLOGJI 1 - Transaksione nga jo rezident

Shtetasi i huaj jo rezident në Shqipëri 'T', në shkurt të vitit 2015, ka hapur një llogari personale në vendin tonë së bashku me një shtetase shqiptare "B" në një nga bankat që operojnë në vendin tonë.

Menjëherë pas hapjes së llogarisë së përbashkët, në këtë llogari ka ardhur një transfertë në shumën 150 000 euro nga një shtet i njohur si 'parajsë fiskale' dhe dërguesja ishte shtetësja e huaj 'A' pa një lidhje të qartë me përfituesit.

Shuma ishte dërguar në bazë të një kontratë huaje, sipas së cilës shtetasi "T" i kishte marrë hua shtetases 'A' për një afat 2 vjeçar.

Pas ardhjes së kësaj shume, shtetasi i huaj 'T' është paraqitur në bankë dhe ka tërhequr 50 000 euro dhe arsyeja e tërheqjes ishte se do të investonte në pasuri të paluajtshme në vendin tonë. Po në të njëjtën ditë, ky shtetas është paraqitur në një degë tjetër të bankës dhe ka kërkuar që pjesën tjetër të fondeve ta rikthejë te dërguesja me përshkrim 'kthim fondi'.

Disa muaj më vonë shtetasi 'T' së bashku më një shtetas tjetër të huaj "D" regjistrojnë një biznes në vendin tonë, ku secili zotëronte 50% të aksioneve. Shoqëria '@' e regjistruar prej tyre kishte objekt veprimtarie tregtimin dhe punimin metaleve të çmuara dhe administratore ishte shtetasja shqiptare "B", me të cilën shtetasi "T' ka llogari të përbashkët siç është përmendur më sipër.

Një muaj pas regjistrimit, në këtë shoqëri përfshihet edhe një shtetas tjetër i huaj si ortak (ka të njëjtën shtetësi si dy ortakët e tjerë), shtetasi 'M", i cili bleu 30% të aksioneve të shoqërisë.

Shoqëria '@' hapi llogari në një nga bankat tregtare në vendin tonë dhe disa ditë nga hapja e kësaj llogarie në emër të kësaj shoqërie kanë ardhur disa transferta nga jashtë në vlera të larta, nga shoqëria '&' jashtë vendit. Për justifikimin e këtyre transfertave janë paraqitur fatura shitjeje, sipas së cilës shoqëria '@' (e cila kishte përfituar fondet) i kishte shitur shoqërisë dërguese të fondeve metale të çmuara në një vlerë të barabartë me shumën e transferuar.

Gjithashtu, u paraqitën edhe fatura blerjeje, sipas së cilës shoqëria '@' kishte blerë, nga individë të shtetit nga kishin ardhur transfertat, sasi të konsiderueshme ari.

Pasi fondet erdhën në llogarinë bankare të shoqërisë "@" në vendin tonë, pjesa më e madhe u tërhoqën nga administratorja dhe nga njëri prej ortakëve, duke deklaruar se do të përdoreshin për blerje 'metalesh të çmuara' në vendin tonë.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se në të njëjtat ditë të tërheqjeve të fondeve, shtetasit të cilët kishin tërhequr fondet kishin deklaruar në kufirin shqiptar fonde me të njëjtët vlera me ato të tërhequra dhe me destinacion jashtë vendit.

Në vijim të analizimit të rastit rezultoi se:

– Njëri nga ortakët e shoqërisë, konkretisht shtetasi "M", ishte i përfshirë në një organizatë kriminale tepër të njohur në vendin e tij;

– Fondet që vinin nga jashtë tërhiqeshin nga administratorja apo ortakët dhe transportoheshin sërish në vendin nga kishin ardhur;

– Nuk rezultonin zhdoganime në emër të shoqërisë "@";

– Edhe pse shoqëria '@' ishte regjistruar në vendin tonë, nisur nga faturat e paraqitura, aktivitetin e zhvillonte jashtë, ndërkohë që fondet vinin në vendin tonë, tërhiqeshin dhe transportoheshin drejt vendin nga kishin ardhur shumat fillimisht;

Për sa më sipër, rasti është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema nr. 1



Tipologji 2: Investime të dyshimta nga Personi i Ekspozuar Politikisht

DPPPP-ja është informuar nga një subjekt i ligjit se një shtetas i huaj (PEP) me llogari bankare të hapur në një nga bankat në Shqipëri kishte kërkuar të transferonte shumën 200 000 EUR në favor të të birit në një vend Evropian për të blerë një apartament.

Duke marrë në konsideratë shumën e konsiderueshme për transfertë, përfshirjen e një PEP si dhe informacione të tjera nga baza jonë e të dhënave, DPPPP-ja e çmoi të nevojshme nxjerrjen e urdhrit të bllokimit të përkohshëm mbi llogaritë e këtij shtetasi, me një balancë aktuale në vlerë të lartë.

Gjatë investigimit të rastit për këtë shtetas është konstatuar, gjithashtu, se:

Në vitin 2008, shtetasi "D" (PEP) kishte hapur dy llogari bankare në Shqipëri dhe në të njëjtën ditë kishte depozituar 1 000 000 euro në cash, ndërkohë që disa ditë më vonë depozitoi, gjithashtu, edhe shumën prej 250 000 euro.

Gjatë periudhës 2011 – 2015, shtetasi "D" kishte kryer disa transaksione në llogarinë në Shqipëri, duke përfshirë tërheqje cash dhe disa transferta jashtë Shqipërisë, konkretisht:

- Shumën 250 000 euro në favor të një kompanie në një vend evropian për blerje rezidence,
- 412 000 euro transfertë në llogarinë e tij personale jashtë Shqipërisë,
- 300 000 euro në favor të një kompanie "X" në SHBA për blerje apartamenti,
- 100 000 euro transfertë në Kanada në favor të një kompanie për pagesë kredie në emër të gruas së tij.
- Tërheqje cash në shumën 126 000 euro.

Në vijim të verifikimeve të kryera, në sistemin TIMS, rezultoi se ky shtetas kishte disa hyrje – dalje, dhe gjithashtu në datën e depozitimit të shumës 1 000 000 euro kishte udhëtuar me makinë i shoqëruar nga një shtetas i huaj "E".

Nga burime të hapura ka rezultuar gjithashtu se:

- Shtetasi "D" është menaxher i përgjithshëm në një subjekt privat në vendin e tij dhe shtetasi "E" është i punësuar dhe bashkëpunëtor i afërt i tij.
- Në vitin 2010 shtetasi "E" është arrestuar në një vend të BE-së pasi është kapur me 750 000 euro cash të padeklaruara. Këto fonde vinin nga kompania e shtetasit "D" dhe ka deklaruar se do i përdorte për t'i investuar në këtë vend.

Duke marrë në konsideratë dyshimet e mësipërme dhe përfshirjen e shumë shteteve të huaja, kemi dërguar informacion jo vetëm në NJPH dhe DPPSH por edhe në institucionet homologe të huaja të përfshira në rastin konkret.

Skema nr. 1


Albania
Menaxher
ne vendin e tij
te origjines
Media Group
PEP
(shtetasi D / i huaj)
ka udhetuar
ne Shqiperi
kompanite dhe llogarite bankare jane
te gjitha ne vende te huaja te ndryshme
Kompania 1
250 000
per blerje
rezidence
2008 - 1 250 000 EUR
deposituar cash
ne te njejten dite qe
ka kryer dhe depositen
Kompania 2
300 000 EUR
per blerje
apartamenti
Cash
Kompania 3
100 000 EUR
pagese kredie
412 000 EUR
with car
llogari personale
200 000 EUR
kerkese per transferte
e pa kryer
Llogari bankare ne Shqiperi
ka udhetuar gjithashtu ne Shqip
i shoqeruar me shtetasin D
djali i tij
I punesuar
Burime te hapura
eshte arrestuar ne nje vend ne EU
nderkohe qe po transportonte shumen
EUR 750,000 (fonde te padeklaruara)
Shtetasi E

SEKTORI I ANALIZËS STRATEGJIKE

Në vitin 2015, puna e Sektorit të Analizës Strategjike, ka konsistuar kryesisht në:

- Rishikimin e vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT;
- Kryerjen e një analize sektoriale për shoqëritë e transfertave nga përpunimi i të dhënave të të cilave është arritur nga referimi i një sërë rasteve të rëndësishme të dyshuara si të lidhura me trafikun e lëndëve narkotike, krimin e organizuar etj.

Vendi ynë, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtarë, në tetor 2012, përfundoi dhe paraqiti në Komitetin e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) dokumentin e parë për Vlerësimin Kombëtar të Riskut të Pastrimit të Parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT).

Në vijim, me hyrjen në fuqi të rekomandimeve të reja të FATF-së, konkretisht Rekomandimi nr. 1, i cili është risia më thelbësore e këtyre rekomandimeve dhe nga më të rëndësishmit, që i detyron shtetet të kryejnë vlerësime kombëtare risku, dhe mbi bazë të gjetjeve të këtyre vlerësimeve, të marrin masat e përshtatshme për uljen/minimizimin e tyre. Nisur nga ky rekomandim, por edhe nga detyrimi i shprehur në ligj, Sektori i Analizës Strategjike gjatë vitit 2015 është angazhuar në mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave në funksion të kryerjes së një vlerësimi të përditësuar, duke marrë në konsideratë edhe eksperiencën e krijuar dhe praktikat më të reja.

Dokumenti i vlerësimit të riskut i është dërguar sërish KBLKPP-së, të gjitha institucioneve relevante në vend, organeve mbikëqyrëse, subjekteve financiare e më tej konkluzionet e tij janë trajtuar edhe në takime ndërinstitucionale dhe trajnime.

Në këtë kontekst, gjykojmë se vlen të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e vlerësimit të riskut:

1. Ndër vite, mbi bazë edhe të përafrimit me standardet ndërkombëtare dhe asistencës së vazhdueshme, është punuar për ngritjen e një sistemi parandalues sa më efektiv dhe aktualisht sistemi funksionon, pavarësisht se ka edhe sektorë që duhen rivlerësuar në thellësi për të garantuar vazhdimësinë e raportimeve dhe larminë e tyre.
2. Niveli i mbikëqyrjes së profesioneve të lira jofinanciare, lojërave të fatit, tregtarëve të metaleve dhe gurëve të çmuar ka vend për përmirësim të mëtejshëm.
3. Nisur nga të dhënat e përfituara, rezulton se mundësia e zbulimit të rasteve të dyshimta në nivel inteligjence është në nivel të mirë, mirëpo hetimi paraqet probleme të dukshme, dhe kjo ndikon edhe në dërgimin e shumë pak rasteve në gjykatë. Hetimi i rasteve të pastrimit të parave në mënyrë autonome (pra kur personi nuk e ka kryer veprën origjinuese) ngelet ende në nivele të ulëta.
4. Në eficencën e hetimeve ndikon edhe fakti se për një pjesë të konsiderueshme të rasteve nevojitet ekzekutimi i letërporosive nga autoritetet e huaja gjyqësore, ekzekutim ky që kryhet me shumë vonesë dhe që ndikon negativisht në hetim, duke çuar në marrjen e vendimeve të pushimit apo pezullimit të procedimeve penale.
5. Zbatimi i ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*" i ndryshuar është shumë larg pritshmërisë dhe mundësive që ky ligj jep, në kuadër të konfiskimit të produkteve kriminale.

6. Rreziku/kërcënimi kryesor i identifikuar është produkti kriminal, i cili çmohet se buron kryesisht nga trafikimi i lëndëve narkotike, krime në fushën doganore dhe tatimore (si kontrabanda, fshehja e të ardhurave, mashtrimi me TVSH) dhe korrupsioni, vepra këto që mendohet se dominojnë të ardhurat kriminale.
7. Informaliteti në ekonomi dhe përdorimi edhe në shkallë të gjerë i parasë fizike ngelen problem, në kuadër të detektimit dhe hetimit të PP/FT, pasi e vështirësojnë atë.
8. Gjithashtu, ngelet problem transporti i parasë fizike në hyrje/dalje nga pikat e kalimit të kufirit, pasi nga një sërë indicesh konkludohet se ndodh në masë të konsiderueshme, mirëpo deklarimet dhe ndëshkimet për mosdeklarim janë minimale.

Në përputhje me gjetjet e vlerësimit të riskut dhe me të dhëna apo faktorë të tjerë me të cilët njihet, DPPPP-ja e ka orientuar edhe punën e vet,

– Është kryer edhe një analizë e detajuar e trasaksioneve të shoqërive të transfertave, bazuar në parametra të caktuar dhe me shtrirje kohore deri në 5 vjet, me fokus edhe për transaksionet me vende me risk;
– Të dhënat janë marrë në konsideratë në kuadër të planifikimit dhe verifikimit të përputhshmërisë së subjekteve në raport me detyrimet e tyre të shprehura në ligj.

ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE

Teknologjia e informacionit është një ndër elementet më të rëndësishme në sigurimin e mbarëvajtjes së punës në DPPPP, duke qenë se sasia e informacionit që raportohet dhe përpunohet ka njohur rritje.

Një theks i veçantë i është kushtuar raportimit elektronik të subjekteve të ligjit, që është mundësuar në saje të përmirësimit të moduleve të përdoruesve dhe trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë sjellë lehtësi, siguri dhe shpejtësi të transmetimit të informacionit.

Një aspekt tjetër i punës është dhe përmirësimi i infrastrukturës së DPPPP-së, që ndikon në rritjen e mëtejshme të efektivitetit të punës dhe analizimit të informacionit.

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Edhe gjatë vitit 2015 ka vijuar bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë e Përgjithshme, që është shoqëruar me trajtimin e shpejtë dhe efektiv të rasteve për të cilat DPPPP-ja ka nxjerrë urdhra bllokimi të përkohshëm.

Përveç rasteve të cilat DPPPP-ja referon në Polici/Prokurori, në mënyrë të vazhdueshme merr kërkesa prej tyre dhe kthen përgjigje për persona në hetim. Tabela paraqet të dhënat për kërkesat (dhe numrin e personave të përfshirë) që DPPPP-ja ka marrë në vitin 2015.

Tabela nr. 9

	Kërkesat	Nr. i personave
Prokurori/polici	303	1775

Gjithashtu, është bashkëpunuar edhe me organe të tjera, në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- Me SHISH-in, në kuadër të investigimit të rasteve të krimit të organizuar, atij makrofinanciar dhe sidomos në lidhje me rastet e dyshuara për financim terrorizmi;
- Me DPT-në, në kuadër të trajtimit të një tipologjie të përhapur (atë të kryerjes së transaksioneve të biznesit në llogari individuale), për të cilën janë marrë masa konkrete dhe ka pasur rezultate mjaft pozitive.
    - DPT-ja iu është përgjigjur në kohë dhe në mënyrën e duhur kërkesave për informacion dhe DPPPP-ja, në kuadër të njësive të përbashkëta hetimore apo më gjerë, e ka njoftuar DPT-në për 85 raste, të cilat kanë rezultuar të lidhura me evazionin fiskal/fshehjen e të ardhurave.
    - Në raport me DPT-në mbetet ende problem numri i ulët i RAD-ëve të dërguar prej tyre dhe mbikëqyrja ende jo në nivelin e duhur e organeve tatimore për OJF-të, detyrim ky i mirëpërcaktuar ligjor.
- Bashkëpunimi me ILDKPKI-në ka njohur rritje të mëtejshme dhe ka dhënë rezultate konkrete.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi me FATF

Në vitin 2015 DPPPP-ja ka vijuar punën për të ndjekur me prioritet procesin e raportimit në FATF, në funksion të planit të veprimit të hartuar në periudhat e mëparshme. Në këtë kontekst, një vëmendje në rritje i është kushtuar koordinimit ndërinstitucional me institucionet e përfshira në këtë proces (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë) dhe bashkëpunimit me shoqatën e bankave të Shqipërisë, dhomën kombëtare të noterëve dhe të avokatëve.

Në këtë kuadër, në muajin janar 2015, një ekip ekspertësh i FATF ka vizituar Shqipërinë, në funksion të vlerësimit të masave të marra në vend nga autoritetet shtetërore si dhe subjekteve private në drejtim të rekomandimeve të bëra për këtë qëllim.

Bazuar në efektivitetin e masave të sipërpërmendura, në mbledhjen plenare të FATF, të mbajtur në muajin shkurt 2015, është vendosur heqja e Shqipërisë nga lista e vendeve me mangësi në zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Bashkëpunimi në kuadrin e grupit EGMONT

Në vitin 2015, DPPPP-ja ka vijuar angazhimin aktiv në punën e Grupit Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare, i cili paraqitet në vijim në mënyrë të detajuar.

Në datat 27 – 28 janar 2015 janë zhvilluar takimet e grupeve të punës së Egmont në Berlin, në të cilin DPPPP-ja është përfaqësuar rregullisht. Në datën 27.01.2015, grupi mbështetës ka vijuar diskutimin në lidhje me çështjen e anëtarësimit të NjIF së Kosovës në Grupin EGMONT dhe ka shqyrtuar informacionin e përgatitur për këtë qëllim.

Një vend të rëndësishëm në këtë takim ka zënë dhe procesi i riorganizimit të grupeve rajonale, në vijim të të cilit përfaqësuesi i DPPPP-së është zgjedhur të koordinojë për një periudhë dy vjeçare punën e grupit Europa II, i cili përfshin njëzet njësi të inteligjencës financiare të Europës Qëndrore dhe Lindore.

Në datat 07-08 qershor 2015 u mbajt në Barbados mbledhja e 23-të plenare e Grupit EGMONT, në të cilin drejtues të DPPPP-së, kanë marrë pjesë aktive në takimet e Komitetit të këtij Grupi, Grupit Mbështetës dhe atij Ligjor.

Një vend të rëndësishëm në këtë seancë plenare i është kushtuar marrëdhënieve mes Grupit Egmont dhe Rrjetit Global të Koordinimit të FATF; raportimet e Grupeve rajonale në kuadrin e të cilit nga DPPPP-ja është bërë prezantimi i punës së Europa II të shoqëruar me propozimet konkrete për mbarëvajtjen e mëtejshme të punës së modelit rajonal (Regional Footprint), mënyra e komunikimit me NjIF që nuk janë të njohura ndërkombëtarisht; plotësimi i objektivave të planit strategjik dhe harmonizimi i aktivitetit në kuadrin e tranzicionit në grupet e reja të punës; risqet e financimit të terrorizmit që lidhen me shtetin islamik; forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe sigurisë së NjIF si dhe trajnimi i drejtuesve të NJIF në drejtim të vlerësimit të riskut dhe zbatimit efektiv të rekomandimeve ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me Komitetin MONEYVAL të KiE

Përfaqësuesit e DPPPP-së kanë vijuar kryesimin e delegacionit Shqiptar dhe pjesëmarrjen aktive në seancat plenare të Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës të mbajtura në muajt prill, shtator dhe dhjetor 2015.

Në këtë kontekst, një vend të rëndësishëm në punën e drejtorisë ka zënë dhe koordinimi i vazhdueshëm ndërinstitucional me Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme si dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Në seancën e 48-të Plenare, të mbajtur në muajin shtator 2015, komiteti ka marrë në shqyrtim raportin e përgatitur nga ana e autoriteteve Shqiptare, në të cilin është pasqyruar progresi i bërë në funksion të zbatimit të rekomandimeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Bashkëpunimi me këtë komitet është shtrirë dhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve në funksion të zbatimit të rekomandimeve ndërkombëtare të FATF, zbatimit të Konventës së Varshavës, vlerësimit të përgatitjes së vendit për realizimin e detyrimeve që lindin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kundër financimit të terrorizmit.

Shkëmbimi i informacionit me NjIF

Bashkëpunimi ndërkombëtar më NjIF homologe, përbën një element të rëndësishëm të punës së Drejtorisë se Përgjithshme te Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe të dhënat e detajuara statistikore paraqiten në tabelën e mëposhtme

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT ME HOMOLOGËT

Tabela nr. 10

VITET	Kërkesa nga NJIF	Përgjigje nga DPPPP	Kërkesa nga DPPPP	Përgjigje nga NjIF
2013	56	70	35	28
2014	62	48	66	50
2015	77	63	58	47

Në funksion të rritjes së efektivitetit të kthimit të përgjigjeve për kërkesat e marra nga homologët, DPPPP-ja ka synuar që ky proces të kryhet brenda afateve të përcaktuara në përputhje me parimet e grupit EGMONT, ndërkohë që rastet e veçanta janë trajtuar me prioritet të lartë.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2016

- Analizimi dhe referimi i rasteve në agjencitë e zbatimit të ligjit.
- Inspektimi në kategori të subjekteve të ligjit të vlerësuara me risk më të lartë në drejtim të përputhshmërisë;
- Rritje e ndikimit, në mënyrë të veçantë përmes inspektimeve në vend në sektorin financiar, sidomos atë bankar;
- Bashkërendimi i punës me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese në drejtim të inspektimeve të përbashkëta si dhe adresimi i problematikave që lidhen me mbikëqyrjen;
- Konsolidimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës së TI;
- Digjitalizimi i arkivës;
- Përvetësimi dhe zbatimi i përvojës ndërkombëtare.